



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201801827/3

Tiranë ___/___/2018

Lënda: Rekomandime përmirësimit e punës të strukturave përgjegjëse në nivel vendor për identifikimin, mbrojtjen dhe integrimin e fëmijëve në nevojë në Njësinë Administrative Kashar.

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHËRBIMEVE SOCIALE

BASHKISË TIRANË

ZNJ. ANISA RUSETI

NJËSISË ADMINISTRATIVE KASHAR

TIRANË

Në emisionin "Stop", të televizionit kombëtar "Klan", u transmetua një kronikë, për mbështetjen e njerëzve në nevojë, ku në qendër të të cilës u trajtua rasti i një familjeje me tre fëmijë, në gjendje shumë të vështirë ekonomike.

Për një shqyrtim sa më objektiv të kësaj ngjarje të ndodhur në Bashkinë Tiranë, Njësia Administrative Kashar, si dhe për të bërë të mundur kryerjen e misionit tonë kushtetues, mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të fëmijëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme apo të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, institucioni i Avokatit të Popullit realizoi inspektimin në shkollën 9-vjeçare "Kasem Shima". Qëllimi i realizimit të këtij procesi inspektimi ishte vlerësimi i veprimtarisë së institucionit të edukimit dhe ushtrimi i së drejtës për t'u arsimuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Metodologjia e inspektimit u fokusua në zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e këtij institucioni dhe psikologun, kontrollin e dokumentacionit përkatës, që lidhet me problematikën e inspektimit, si edhe monitorimin e zhvillimit të mësimin në klasat respektive të fëmijëve me inicialet, A. Sh., E.Sh. dhe G.Sh., të shfaqur në emisionin “Stop”.

Nga intervista e realizuar me drejtuesit e shkollës 9-vjeçare “Kasim Shima”, znj. Asime Lamaj, drejtues, znj. Vjollca Gjolli nëndrejtoreshë dhe psikologes së shkollës, konstatuan si më poshtë vijon:

Familja Shima është e përbërë nga pesë anëtarë, bashkëshorti, bashkëshortja dhe tre fëmijët, të cilët vitin e kaluar kanë ndjekur rregullisht shkollën. Konkretisht, fëmija me inicialet G. SH. në klasën e gjashtë, fëmija me inicialet A.Sh., në klasën e katërt dhe fëmija me inicialet E.Sh. në klasën e parë.

Kjo familje është e përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike dhe prindërit nuk janë në marrëdhënie pune. Në këtë kontekst, fëmijët e familjes Shima nuk kanë përfituar subvencionimin e librave shkollorë. Drejtoria e shkollës kishte mundësuar pajisjen me libra të falur nga nxënësit, që kishin mbaruar vitin shkollor pararendës. Mjetet shkollorë shpesh herë u janë siguruar nga vetë mësuesit ose shokët e klasës dhe, në më të shumtën e rasteve ato i mungojnë. Rezultatet në mësim të të tre fëmijëve lënë për të dëshiruar.

Shkolla nuk bashkëpunonte me asnjë organizatë të shoqërisë civile. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësinë Administrative Kashar, vitin e kaluar nuk ka qenë prezent asnjëherë në shkollë, në funksion të përmbushjes së detyrave të parashikuara nga neni 49, i ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Kjo njësi duhet të identifikojë të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike të mbrojtjes së fëmijës, në territorin e bashkisë, duke përfshirë përfaqësues nga shërbimet e kujdesit alternativ, të shërbimit shëndetësor, psikologjik, social, ligjor, punonjës të specializuar të rendit, përfaqësues të organit të prokurorisë dhe të institucioneve arsimore, si dhe të ndërgjegjësojë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë.

Për herë të parë Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësinë Administrative Kashar është paraqitur në shkollë, të nesërmen e transmetimit të emisionit “Stop”, në televizionin “Klan”, të rastit në fjalë. Pavarësisht legjislacionit në fuqi, ku rastet e fëmijëve, të cilët vijnë nga varfëria ekstreme duhet të referohen në Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës, brenda njësisë administrative, drejtuesi i shkollës nuk e ka referuar këtë rast, për arsye të mungesës së pikave të kontaktit të këtyre strukturave, si dhe përpjekjeve individuale, të bëra nga ana e saj, për t’i zgjidhur këto problematika.

Gjithashtu, u informuam se ditën e nesërme, menjëherë pas transmetimit në emisionin “Stop”, në televizionin “Klan”, babai i fëmijëve z. Ismail Shima, i cili nuk di shkrim edhe lexim, është paraqitur në drejtori, ku ka lëshuar një deklaratë. Në të, me vullnetin e tij të lirë është shprehur, se nuk ka asnjë ankesë për mësuesit e shkollës, ku edukohen fëmijët e tij. Ai thekson, që nuk ka dijeni, pse fëmija i tij e ka bërë atë deklaratë para gazetarit dhe, se asgjë prej atyre që ka thënë fëmija me inicialet E. Sh. nuk është e vërtetë.

Në takimin e organizuar në mjediset e shkollës, ku prindi z. Shima ka nënshkruar edhe deklaratën sa më sipër, nga autoritetet drejtuese të shkollës, është mbajtur edhe procesverbali përkatës në praninë edhe të disa mësuesve. (mësuesve kujdestar dhe nëndrejtoreshës). Po kështu, për rastin në fjalë në shkollë janë paraqitur edhe përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Tiranë, për trajtimin e problematikave të transmetuara në media.

Nga biseda e zhvilluar me psikologun e shkollës, u informuam që ajo e ushtronte funksionin e saj në katër shkolla njëherazi, si vijon; Kashar Qendër, Kashar Kodër, Yzberisht dhe Katund i Ri, ku edukohen rreth 1750 nxënës. Në shkollën 9-vjeçare “Kasem Shima”, ajo punonte 4 herë në muaj. Në asnjë moment nuk ka patur referim nga mësuesit kujdestarë, vetë prindërit ose fëmijët, lidhur me dhunën ose diskriminimin që fëmijët kanë ndjerë gjatë edukimit të tyre në shkollë. Pas transmetimit në media të emisionit, ajo ka kryer biseda të lira me dy prej fëmijëve, ku ka evidentuar mungesën e përgjegjshmërisë prindërore për mirërritjen e fëmijëve.

Nga monitorimi i fëmijëve gjatë zhvillimit të orës së mësimi, fëmija me inicialet E.Sh., aktualisht në klasën e dytë, ishte i ulur në bankën e parë me nxënësen me rezultatet më të mira në mësim. Fëmija ishte i pajisur me të gjitha librat dhe mjetet shkollore të duhura. Në sjelljen e tij dalloheshin probleme të theksuara të mungesës së përqëndrimit, ku libri ishte i hapur jo në të njëjtën faqe me nxënësit e tjerë të klasës, si dhe probleme të theksuara në zhvillimin konjuktiv (të nxënësve), ku nuk arrite dot të lexonte.

Gjatë monitorimit të zhvillimit të orës së mësimi në klasën e fëmijës me inicialet A.Sh. u vërejt, që fëmija nuk kishte nxjerrë librin e muzikës, të cilin e kishte harruar në shtëpi, pasi kishte munguar në shkollë. Si rezultat, nuk ishte njohur me orarin mësimor të ditës pasardhëse. Nga mësuesja kujdestare u informuam, që fëmija me inicialet A.Sh. është pajisur me të gjitha librat, nga nxënësit që kanë mbaruar klasën e gjashtë, përveç matematikës, që mungonte si tekst, pasi ka ndryshime në përmbajtje të tekstit mësimor. Mësuesi i matematikës na informoi, se shumë shpejt, do t’u kishte në dispozicion një kopje, të mundësuar nga shtëpia botuese përkatëse.

Gjatë monitorimit të mjediseve në klasa u vërejt, se kushtet higjeno-sanitare nuk ishin në standardet minimale të kërkuara. Në përgjithësi, te nxënësit e kësaj shkolle, vërehej që familjet e tyre kanë probleme ekonomike të dukshme. Kjo u konstatua, edhe nga bisedat e zhvilluara me drejtuesit dhe mësuesit e shkollës, ku familjet në përgjithësi ankoheshin për pamundësi të pagesës së detyrimit prej 1000 (njëmijë) lekë, në fillim të vitit mësimor, pavarësisht se është detyrim vullnetar. Gjithashtu, u informuam se pjesëmarrja e prindërve gjatë mbledhjeve mujore në mjediset e shkollës me stafin pedagogjik, ishte shumë e ulët.

Përfundime dhe rekomandime

Për sa më sipër, familja Shima dhe tre fëmijët e kësaj familjeje, jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike.

Nga vlerësimi i të dhënave të sipërpërmendura, lidhur me masat që duhet të ndërmerreshin për zgjidhjen e problemit në interesin më të lartë të fëmijës, nga strukturat përgjegjëse në nivel vendor, ku çdo fëmijë gëzon të drejtën për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën si dhe në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve, institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar, që kjo ka ardhur si rezultat i:

- mosmarrjes së masave nga administratori shoqëror dhe strukturat e tjera përgjegjëse në momentin, që familja Shima është përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike, gjatë aplikimit të sistemit të pikëzimit. Pavarësisht shkakut të përjashtimit, administratori shoqëror i njësisë administrative, Kashar, Tiranë, në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale (psh,verifikimi i situatës social-ekonomike i familjeve në nevojë), ka patur informacion të mjaftueshëm për këtë familje mbi gjendjen e vështirë ekonomiko-sociale, në të cilën ajo ndodhej. Në vlerësim edhe të legjislacionit në fuqi, udhëzimit, nr.5, datë 17.2.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, mund të ishte parë mundësia e përfshirjes së familjes Shima në fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%.
- mosreferimi i familjes Shima nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Kashar, në Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, po të kësaj njësie, në mbështetje të udhëzimit nr.10, datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse

për mbrojtjen e fëmijës”. Familja Shima është përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike, ku në strukturën e saj familjare ka tre fëmijë të cilët kishin nevojë për mbrojtje.

- moszbatimi i detyrave funksionale të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, Njësia Administrative Kashar, për identifikimin e të gjithë aktorëve dhe ofruesëve të shërbimeve publike dhe jopublike të mbrojtjes së fëmijës brenda territorit nën juridiksionin e kësaj njësie, duke përfshirë përfaqësues nga shërbimet e kujdesit alternativ, të shërbimit shëndetësor, psikologjik, social, ligjor, punonjës të specializuar të rendit, përfaqësues të organit të prokurorisë dhe të institucioneve arsimore¹, si dhe në ndërgjegjësimin e komunitetit, për organizimin e takimeve informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit, nën juridiksionin e njësisë².

Përprjekjet e deritanishme, për të finalizuar të gjitha ato që përmendëm më sipër, në përputhje me konventat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës, që garantojnë realizimin efektiv të mbikëqyrjes, promovimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave, janë një fillim i mirë, por që kërkon ende shumë punë për të bërë, shumë përprjekje nga të gjithë ne, shoqëria, të gjithë aktorët dhe faktorët me ndikim në ciklin e politikave publike, ojf-të, etj.

Besojmë, se çdo lloj investimi të fëmijët, që promovon potencialin e tyre sot e, që nxit në ta vetëbesimin e nevojshëm, për t’u bërë anëtarë të dobishëm të shoqërisë nesër, qytetarë të përgjegjshëm e me norma, është një investim me vlerë, i cili ka nevojë për përmirësim të vazhdueshëm.

Për këtë qëllim, në mbështetje edhe të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDOJMË:

- vlerësimin e të gjitha mangësive të konstatuara nga institucioni i Avokatit të Popullit marrjen e masave të duhura, për tërheqjen e vëmendjes stafit përgjegjës, të cilët kanë shkaktuar, me veprimet ose mosveprimet e tyre, shkeljen e të drejtave të fëmijëve;
- punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në Njësinë Administrative Kashar, të marrë masat e nevojshme, për mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial

¹ Në mbështetje të shkronjës “d”, të nenit 49, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

² Në mbështetje të shkronjës “e”, të nenit 49, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, për fëmijët me inicialet, A. Sh., E.Sh. dhe G.Sh.;

- marrjen e masave të menjëhershme, për organizimin e takimeve informuese me të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike (si shkollat, çerdhet, kopshtet, etj.), për mbrojtjen e fëmijës në interesin më të lartë të tyre.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA